

STATUTI I SHOQËRISË TREGËTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"EUROCALL ALBANIA" Sh. P. K.

Në Tiranë më datë 19 Prill 2021, **Oscar Capelletti** i biri i Giuseppe dhe Angela, lindur në Romano di Lombardia (BG) Itali më 21.08.1977 banues në Itali ne adresen Via Galileo Galilei, N.341.9 Romano Di Lombardia (BG) Itali , shtetas italian, i pajisur me Karte Identiteti Italiane CA56707IL, *vendosa të krijoj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, si mëposhte:*

Neni 1 EMËRTIMI

Themelohet Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar: **"Eurocall Albania" Sh. P. K.**

Neni 2 OBJEKTI

Objekti i veprimtarise ekonomike te Shoqerise **"Eurocall Albania" Sh. P. K** eshte:

- Ofrimin e te gjitha sherbimeve qe lidhen me "Call Center" dhe Contact Center duke perfshire edhe perpunimin e te dhenave te shoqerive te tjera dhe/ose enteve publike,ndermjetesim tregtare dhe marketing ne fushen e sherbimeve telematike dhe telefonike,veprimtarite e lidhura dhe te ngjashme me ato te renditura me siper,te blej,te shesi,te marri hua,te japi me qira te mira te tundeshme e te patundeshme dhe çdo gje tjeter te nevojshme e te vlefshme per realizimin e drejperdrejte o te terthorte te qellimit te shoqerise.

Neni 3 SELIA

"Eurocall Albania"Sh. P. K e ka seline e saj ne: Rruga Ura e Limuthit, afer City Park, Zona Kadastrale 2105, Kashar, Tirane

Neni 4 KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Afati i veprimtarisë të kësaj Shoqërie është *pa afat të caktuar*, por aktiviteti fillon data e nënshkrimit të këtij akti.

Neni 5

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin, seline, kohezgjatjen dhe objektin e veprimtarise se saj sipas vendimeve qe do te marre Asambleja e Ortakeve.



KAPITALI I SHOQERISE

Neni 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise eshte ne vleren prej **100.000 leke** (njqindmije), e barasvlefshme me nje kuote te vetme. Pjesemarrja e ortakeve ne kapital eshte si meposhte:

Z. Oscar Capelletti zoteron 100 % te kuotave ose 1 kuote te barabarta me vleren 100.000 (njqindmije) Leke, ne kapitalin themeltar.

Neni 7

PERBERJA E KAPITALIT

Kapitali i shoqerise perbehet nga kontributi i otakut te vetem ne natyre ose ne para te kapitalizuara ne te gjitha aktivet afatgjata dhe qarkulluese te nevojshme per veprimatine e Shoqerise.

Neni 8

NDRYSHIMII KAPITALIT

Kapitali themeltar mund te shtohet ose te ndryshohet vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme .

Neni 9

TRANSFERIMI I KAPITALIT

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie. Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne Shoqeri.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 10

ASAMBLEJA

Organi kryesor vendimor i Shoqerise eshte Asambleja e Pergjithshme, ne te cilen ortaket marrin pjese ne vendim, me te drejte vote perpjestimisht me kuoten kapitalit themeltar te cilen zoterojne.

Neni 11

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Asambleja e Pergjithshme vendos per:

- miratimin ose mosmiratimin e bilancit vjetor dhe pasqyrave financiare bashkeshoqeruese
- emerimin, zevendesimin dhe shperblimin e Administratorit te vetem ose te drejtuesve te tjere te Shoqerise
- emerimin, zevendesimin dhe shperblimin e Ekspertit Kontabel te Autorizuar
- direktivat strategjike per veprimtarine e Shoqerise



- ndryshimet ne Statut dhe ne Aktin e Themelimit
- shtimin ose pakesimin e kapitalit themeltar
- zgjatjen ose pakesimin e kohezgjatjes se veprimtarise se Shoqerise
- pushimin e veprimtarise se Shoqerise
- transformimin e Shoqerise nga SHPK ne forma te tjera shoqerish.

Neni 12

Vendimet e Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise, ne perputhje me legjislacionin shqiptar, jane te detyrueshme per te gjithë Ortaket, perfshire ketu edhe ata qe nuk kane qene te pranishem ose kane votuar kunder.

Neni 13

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Administratoret ose Administratori i Vetem, jane format me te cilat mund te administrohet Shoqeria. Keto organe emerohen nga Asambleja e Pergjithshme per nje periudhe **5-vjecare** me te drejte rizgjedhje. Ortaku i vetem vendosi qe Shoqeria do te administrohet nga Administratori i Vetem i cili do te jete z. Oscar Capelletti, me te gjitha pushtetet qe i njeh ligji.

Neni 14

KOMPETENCAT

Sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e aktivitetit te Shoqerise, Administratori i emeruar i ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne emer te Shoqerise me perjashtim te rasteve te vecanta qe ligji i jep shprehimisht kete te drejte Asamblese se Pergjithshme.

Neni 15

PERFAQESIMI I SHOQERISE

Perfaqesimi i Shoqerise i perket Administratorit te saj, z. Oscar Capelletti. Ne mungese te tij, Shoqeria perfaqesohet nga perfaqesuesi ligjor me prokure te noterizuar vetem sipas tagreve te caktuara ne prokure.

VEPRIMTARIA EKONOMIKE

Neni 16

VEPRIMTARIA E SHOQERISE

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj sipas objektit dhe ne baze te parimeve ekonomike duke pasqyruar rezultatet ne bilancin e saj. Veprimet e Shoqerise pasqyrohen ne kontabilitet duke zbatuar parimet baze te kontabilitetit te parashikuara ne legjislacionin shqiptar.



Neni 17
VITI FINANCIAR

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare i fillimit te veprimtarise, fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise, dhe mbaron me 31 Dhjetor. Po keshtu dhe viti kur mbyllet veprimtaria, fillon me 1 Janar dhe mbaron ne daten e c' regjistrimit te Shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Neni 18
BILANCI

Bilanci dhe pasqyrat ekonomiko-financiare te Shoqerise mbyllen me 31 Dhjetor te cdo viti dhe paraqiten per shqyrtim ne Asamblene e Pergjithshme, brenda dates 30 Qershor te vitit pasardhes.

Neni 19
FITIMI

Fitimet neto te Shoqerise qe rezultojne nga bilanci, pasi te zbriten shumet qe u perkasin detyrimeve ligjore, fondit rezerve dhe te tjera te percaktuara me ligj ose ne Statut, me vendim te Asamblese se Pergjithshme ndahen perpjestimisht sipas kontributit perkates te Ortakeve.

Neni 20
MARREDHENIET E PUNES

Marredheniet e punes ne Shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per te gjitha ceshtjet qe nuk permenden ne kontraten e punes, zbatohen dispozitat ne fuqi te legjislacionit shqiptar te punes.

Neni 21
KONTROLLI I BRENDSHEM

Shoqeria organizon kontrollin e brendshem me nje Ekspert Kontabel te Autorizuar, i cili eshte pergjegjes perpara kesaj Shoqerie per demet qe mund te shkaktoje nga moskryerja ne rregull e detyres se tij.

PUSHIMI I VEPRIMTARISE

Neni 22
PUSHIMI

Veprimtaria e Shoqerise pushon me mbarimin e afatit te caktuar ne Aktin e Themelimit, me perjashtim te rasteve kur ky afat shtyhet.

 4

Shoqeria mund te pushoje veprimtarine e saj para afatit, me kerkese dhe me vendim te Asamblese se Pergjithshme ose ne rastet e parashikuara ne nenin 23 te ketij Statuti.

Neni 23
SHPERNDARJA

Shoqeria shperndahe;

- me mbarimin e afatit te kohezgjatjes se saj
- ne rast se nuk ka mundesi te realizohet objekti i Shoqerise
- me miratim unanim te te gjithe Ortakeve

Neni 24
LIKUJDIMI

Asambleja e Pergjithshme vendos mbi menytrat e likuidimit dhe cakton nje ose me shume likuidatore duke u caktuar dhe detyrat. Ne rastin e likuidimit emertimi i Shoqerise do te shoqerohet nga shenimi: SHOQERI NE LIKUJDIM E SIPER.

Mbasi behet njoftimmi i mbylljes se likuidimit dhe kryhen formalitetet e duhura, Shoqeria kerkon te cregjistrohet ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

DISPOZITA TE TJERA

Neni 25

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete Statut, referim do te jete Ligji nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare".

Neni 26
MOSMARREVESHJET

Mosmarreveshjet eventuale qe mund te lindin midis Ortakeve gjate zbatimit te ketij Akti Themelimi, ose midis Shoqerise dhe Ortakeve gjate aktivitetit te Shoqerise, duhet te zgjidhen me ane te bisedimeve. Ne rast te kundert palet i drejtohen Gjykates kompetente.

ORTAKU I VETËM
"Eurocall Albania" sh.p.k
Z. OSCAR CAPELLETTI

